



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 6443/12 Prot

Tiranë, më 1.12 2020

U D H Ë Z I M

Nr. 25, datë 1.12, 2020

P Ë R

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019, "PËR
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 80/2015. "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

U D H Ë Z O J:

I. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

- a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi "*në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi*", zëvendësohet me togfjalëshin "*sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik*".
- b) Në pikën 18 të kreut IV/4, togfjalëshi "*...brenda datës 30 nëntor...*", zëvendësohet me togfjalëshin "*...brenda datës 15 dhjetor...*".
- c) Pika I dhe I.1 të kreut V, ndryshojnë, si më poshtë:

"1. IAL-të dorëzojnë në QSHA, në formë shkresore dhe elektronike:

- a) *brenda datës 30 nëntor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".*

- b) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matricullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matricullimit."
- c) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të studentëve që i përkasin pakicës kombëtare romë dhe egjiptiane në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matricullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matricullimit."
- d) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve shtetas të huaj në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matricullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.02.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matricullimit."
- e) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë të studimeve, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/"Master i Arteve", për pajisjen me numër matricullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matricullimit".
- f) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matricullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matricullimit".
- g) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve, "Master Ekzekutiv", për pajisjen me numër matricullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matricullimit".
- d) Pas pikës 4 të kreut V, shtohet pika 4/1, me përmbajtje si më poshtë:

"4/1. Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rejetit Akademik Shqiptar, përjashtëmishi për vitin akademik 2020-2021, ngarkohen të ndryshojnë kalendarin, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, "Master Profesional"/"Master i Shkencave"/"Master i Arteve", për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në

programet e ciklit të dytë të studimeve, si dhe për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve, "Master Ekzekutiv", deri në datë 15.12.2020."

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI

Evis K

